

TI

Dhe Zoti

Ti je...

... shumë pranë.

Por nuk e zotëron **atë!** Për sa kohë mbetet kështu, je i/e humbur! Të afrohet herë pas here, por ti e refuzon – në çdo fazë të jetës tënde...

Ti je...

... shumë i ri/e re

Jeta jote është vrap i pandalur drejt kënaqësisë. Po bën më të mirën tënde për të gjetur atë çfarë mendon se është lumturia.

Filmi i jetës tënde ka filluar dhe dëshpërimisht po mundohesh të luash rolin tënd – por kurrë nuk e di nëse do e gjesh ndonjëherë apo jo.

Së jashtmi duket sikur ke gjithçka nën kontroll.

Por nga brenda teje ulërin...



Ti je...

... shumë i/e zënë

Mundohesh të arrish synimet e tua. Shpeshherë gjërat shkojnë mirë dhe mund jesh në linjë me të tjerët. Por shpesh je i/e pakënaqur. Ulje-ngritjet e jetës vazhdojnë ritmin e tyre pa mëshirë – pa marrë parasysh idetë e tua. Kur shikon jetën tënde, pyet veten, “A është kjo vërtet gjithçka që ekziston?” Por nga brenda ti e di:

Po të mungon diçka...



Ti je...

... shumë i/e
moshuar

Ke përjetuar gjithçka në jetë. Ke kuptuar se qeniet njerëzore nuk janë krijesat fisnike që u pëlqen atyre të mendojnë se janë. Jeta ka lënë shenjë e saj tek ty. Fuqia jote dalëngadalë po venitet. Por kurrë nuk ke gjetur atë që e bën jetën që ia vlen të jetohej – ti ndihesh:

Jo dhe për shumë gjatë, pastaj gjithçka merr fund!



Shumë vonë...

Pastaj koha për ta pranuar **atë** ka përfunduar. Por sot Perëndia ende ia ofron dhuratën e Tij më të mrekullueshme gjithë njerëzve – gjithashtu edhe ty! Ke nevojë për të. Përse??? Sepse je një mëkatar! “Unë? Një mëkatar?” – “Po, ti!” Perëndia tha:

“Sepse të gjithë mëkatuan dhe kanë rënë nga lavdia e Perëndisë.” ROMAKËVE 3:23



“Mëkat? Sa qesharake! Mund të mos jem i/e përsosur, por me siguri s’jam njeri i keq!” Kështu mendon ti. Por Perëndia mendon ndryshe. Ai njeh gjithë jetën tënde dhe nuk ka anashkuar asnjë mëkat, pavarësisht sa “i vogël” është. Është e rëndësishme të dish: Perëndia i quan mëkat edhe mendimet e këqija. Dhe mëkati të ndan nga Perëndia! Tani në këtë jetën dhe në jetën tjetër.

Perëndia është i drejtë. Por për shkak se të do pafundësisht, Ai të bën këtë **ofertë** të mrekullueshme:

Përmes Birit të Tij Jezu Krishtit, Ai ka krijuar të vetmen rrugë që t’i të kthehesh te Perëndia. Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie të gjallë me ty personalisht. Kjo gjë – dhe vetëm kjo – i jep kuptim jetës tënde.

“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.”

GUONIT 3:16

Ama i urryer, i përçmuar dhe në fund i dënuar me vdekje në kryq.

Në fakt, ky duhet të ishte ti. Por sepse Ai të do ty, Ai mbarti ndëshkimin dhe dha jetën e Tij për ty. Perëndia e ka pranuar këtë vepër dhe prandaj e ka ringjallur Atë prej së vdekurish. Varri i tij është bosh. Jezusi është gjallë! Perëndia po të pret. Eja tek Ai. Rrëfeja mëkatet e tua Atij në mënyrë që Ai të të bëjë të lirë. Ai tha:

“Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.”

1 E GUONIT 1:9

Rreth 2 000 vite më parë, Jezu Krishti erdhi në tokë. Porsi njeri. I pamëkat.

Hapja zemrën Atij. Nuk do pendohesh kurrë! Ai të jep paqe të brendshme, mbrojtje dhe gëzim të vërtetë.



Është në dorën tënde!

Pranoje ofertën e Tij.

Nëse refuzon tani, mund të jetë shansi yt i fundit!

“Kërkoni Zotin ndërsa mund të gjendet! ... Kthehuni tek Zoti, ... sepse Ai fal bujarisht.”

SIPAS ISAIA 55:6, 7

© 2024 by GBV Dillenburg GmbH


www.gbv-dillenburg.de

www.gbv-online.org

Numër kontakti për Shqipëri:

0674400217

Lexo online!



Përkthimi i Biblës i përdorur:

Lajmi i Mirë, 1994. Shoqëria Biblike Shqiptare, ABS. © <https://www.biblegateway.com/versions/Albanian-Bible-ALB/>



114 5530

You

Albanian